



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 1115/Prot.
3

Tiranë, më 19/10 2013

Lënda: Rekomandim për "Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë", Tiranë

REKOMANDIM

Nr. 34, datë 19/10/2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organizative dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit,

KONSTATOVA

Nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit, "Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë" Tiranë me objekt:

- **Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi "Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë".**
- ✚ Verifikimi i mbledhjes dhe i përpunimit të të dhënave personale, bazuar në nenet 5, 6, 7, 8 dhe 9 të Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".
- ✚ Qëllimin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale të njoftuar.
- ✚ Verifikimin i Kategorive të të dhënave që përpunohen;
- ✚ Mënyrat e mbledhjes, regjistrimit, përpunimit, përhapjes dhe transferimit të të dhënave;
- ✚ Mjaftueshmërinë dhe proporcionalitetin e përpunimit të këtyre të dhënave përkundrejt qëllimit;
- ✚ Saktësinë dhe përditësimin e të dhënave personale që përpunohen;
- ✚ Kohën e ruajtjes së të dhënave personale që përpunohen;
- ✚ Përhapjen e të dhënave personale të mbledhura e të përpunuara, tek të tretët;
- ✚ Transferimin ndërkombëtar të këtyre të dhënave;

- **Ezaurimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave, bazuar në nenet 12, 13, 18 dhe 19 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, në lidhje me:**
 - ✦ Informimin e subjekteve të të dhënave që ju mbledhen dhe ju përpunohen të dhënat personale dhe marrja e “pëlqimit”;
 - ✦ Rastet, nëse kontrolluesit i është kërkuar nga subjekti i të dhënave përmbushja e të drejtës për akses në përpunimin e të dhënave personale, si dhe nëse është kërkuar korrigjimi ose fshirja e këtyre të dhënave.

- **Siguria dhe politikat e privatësisë për përpunimin e të dhënave personale, bazuar në nenet 20, 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.**
 - ✦ Caktimin e ndonjë përpunuesi të të dhënave personale dhe mbi çfarë akti ligjor;
 - ✦ Vendosjen e kontrollit në aksesin e të dhënave personale të përpunuara dhe përgjegjësitë në administrimin e këtyre të dhënave;
 - ✦ Nivelin e sigurisë fizike dhe teknike të sistemit të përgjithshëm ose të veçantë për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale;
 - ✦ Verifikimin, nëse ka në fuqi ndonjë rregullore të veçantë për mbrojtjen e të dhënave personale ose të ketë rregulla që janë përfshirë në rregulloren e brendshme;
 - ✦ Verifikimin, nëse janë parashikuar dhe zbatohen politikat e mbrojtjes së të dhënave nëpërmjet “*konfidencialitetit*”.

Nga kontrolli administrativ u konstatua se:

Kontrolli administrativ u realizua në Drejtorin e Inspeksionit Metrologjik, Drejtorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve si dhe në Sektorin Juridik, Integritetit dhe Komunikimit.

Gjatë kontrollit administrativ në Drejtorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve u konstatua se në ambientet e zyrës në dollap të mbyllur me çelës dhe derë zyre të mbyllur me çelës mbaheshin dosjet e personelit të ndara në sektor. Në këto dosje mbaheshin dokumente të nëpunësve si: CV, dëshmi penaliteti, certifikatë familjare, raporte mjeko-ligjore, diplomë e noterizuar, certifikata kualifikimi, librezat e punës, fotokopje e kartës së identitetit. Librezat e nëpunësve mbaheshin në kasafortë, tek e cila kishte akses vetëm Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve. Gjithashtu u konstatua se në kompjuterin e Përgjegjëses së Burimeve Njerëzore ekzistonte një listë me emrat dhe mbiemrat e nëpunësve si dhe numrat celularë të tyre për të kontaktuar me ta në raste nevojë. Kompjuteri nuk kishte një fjalëkalim. Këto dokumente mbaheshin për një kohë të pacaktuar, pasi Kontrolli i Lartë i Shtetit, kontrollon në periudha të ndryshme dosjet e nëpunësve të larguar, si dhe të atyre që vazhdojnë punë.

Gjatë kontrollit administrativ u konstatua se kontrolluesi nuk dispononte një rregullore të shkruar për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen e të dhënave personale të klientëve, në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Subjekti kontrollues e ka kryer detyrimin për njoftim ndaj Komisionerit por duhet të përditësoj adresën e Institucionit tek Formulari i Njoftimit pasi ka ndërruar godinë, si dhe zëvendësimin e personit të kontaktit me një person tjetër. Detyra këto që ju lan kontrolluesit me proces-verbal, kontrollit administrativ ishte dhe plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë Komisionerit. Gjithashtu tek rubrika kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen ju keni deklaruar vetëm kategorinë “nëpunës

Në Sektorin Juridik, Integrimin dhe Komunikimin u konstatua se të dy specialistët nuk kishin fjalëkalim hyrës në kompjuterët e tyre. Praktikantët e përfunduar mbaheshin në dollapin e zyrës për një kohë të pacaktuar dhe nuk arkivoheshin pranë zyrës së arkiv-protokollit kur praktika mbyllet nga specialisti përkatës. Praktikantët ishin të pajisura me një kartelë shoqëruese ku shkruhej emri dhe mbiemri i dërguesit nga specialistja e arkiv-protokollit dhe më pas pasi siglohej nga Drejtori përkatës, praktika i dorëzohet specialistit për shqyrtim.

Në Drejtorinë e Inspektimit Metrologjik grupi i kontrollit u njoh dhe shqyrtoi dokumentacionin që kjo drejtori mbante duke patur në fokus të dhënat personale që mblidhen, qëlimin përse mblidhen, ku përhapen (institucione, media etj.), mënyrën e ruajtjes së të dhënave të mblëdhura nga ana e kësaj Drejtorie. Praktikantët që shqyrtoheshin nga inspektorët e kësaj drejtorie ndiqnin rrugën administrative dhe në fund arkivoheshin. Në lidhje me përhapjen e të dhënave në media Drejtorinë e Përgjithshme e Metrologjisë nga të dhënat e nxjerra nga Drejtorinë e Inspektimit Metrologjik (në zbatim të nenit 5 të Ligjit nr. 9875, datë 14.02.2008 “Për metrologjinë” ku citohet shprehimisht: “Rezultatet e matjeve të kryera me kërkesë të organizmave qeveritarë ose që i shërbejnë nevojave të organizmave qeveritarë dhe që kanë lidhje me transaksionet zyrtare, kujdesin shëndetësor, mbrojtjen e mjedisit, rendin publik, sigurinë dhe mbrojtjen e konsumatorit, duhet të vihen në dispozicion të publikut, në përputhje me aktet ligjore në fuqi”, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, çeni 9 Parimi i informimit të publikut dhe mbrojtjes së konsumatorit, ku citohet shprehimisht se: “Inspektori informon publikun për konstatimet dhe masat e marra gjatë procedurës administrative të inspektimit, nëse kjo është e nevojshme për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të personave fizikë e juridikë”.

Nga konstatimet e bëra në Drejtorinë e Inspektimit Metrologjik rezultoi se publikimi i rezultateve të inspektimit bëhej duke publikuar vetëm zonën, arsyen e gjobës, vlerën e gjobës dhe jo të dhënat personale të subjektit tregtar. Kjo sipas Drejtorisë së Inspektimit Metrologjik për arsye se një subjekt tregtar mund të ketë disa pika tregtimi karburanti me pakicë, shpesh të shtrira në gjithë territorin e vendit. Secila pikë tregtimi me pakicë ka në përdorim disa pistoleta/dhënëse karburanti. Gjatë inspektimit mund të rezultojë që vetëm një ose disa pistoleta/dhënëse karburanti në një pikë tregtimi me pakicë të japë sasi jashtë tolerancave ligjore, ndërkohë që në të gjitha pikat e tjera të tregtimit me pakicë të po të njëjtit subjekt tregtar pistoletat/dhënësit kanë qenë plotësisht konform me ligjin. Publikimi i emrit të subjektit tregtar që zotëron pikën me pakicë të tregtimit të karburantit ku ndodhet pistoletat/dhënësi jokonform për sasinë, do i shkaktonte këtij subjekti tregtar dëm jo vetëm për pikën me pakicë konkrete, por për gjithë aktivitetin e tij tregtar në territorin e vendit. Ndërkohë që për pistoletën/dhënësin e karburantit jokonform subjekti dënohet me gjobë. Ndërkohë që për dëmin pasuror në gjithë aktivitetin e tij tregtar si rrjedhojë e mungesës së fitimit, subjektit tregtar i lind e drejta e kërkesës së dëmshpërblimit për dëmin e shkaktuar. Për më tepër që në momentin e publikimit, pistoletat/dhënësit i karburantit jokonform është bllokuar dhe pika e tregtimit me pakicë përkatëse nuk përmben rrezik për marrje sasive karburanti jashtë tolerancës ligjore nga ana e konsumatorit.

Gjithashtu Drejtorinë e Përgjithshme e Metrologjisë ka përgatitur dhe dërguar pranë organeve përkatëse amendimet ligjore të nevojshme, që do e mbështesin në ligj publikimin e emrit të subjektit tregtar si një dënim shtesë.

Nga konstatimet e bëra nga kontrolli i dokumentacionit i cili publikohet në media si dhe nga deklaratimet e bëra nga përfaqësuesi i kontrolluesit nuk u konstatua përhapje e të dhënave personale të subjekteve tregtar.

Në lidhje me këto publikime u konstatua se nga kontrolluesi publikoheshin

Sistemi Informatikë i DPM-së

Nga këqyrja e kompjuterëve personal të punonjësve u konstatua:

Mos përdorimi i fjalëkalimit për të aksesuar sistemin e operativ Windows, në të cilin punonjësi mban dhe përpunon dokumentet që harton. Kjo u provua edhe në ato kompjuterë në zyrë ku punorin bashkë dy ose më tepër punonjës, ndaj rekomandohet marrja e masës nga specialisti IT – administrator i rrjetit, për kontrollin bazë të aksesit të përdoruesve në sisteme me fjalëkalim.

Për shkak se pozicioni i këtij specialisti aktualisht ishte bosh, rolin e tij në rast emergjence e mbulonte për kohësisht një punonjës tjetër i brendshëm që mundësoi dhe aksesin në dhomën e serverit.

Në momentin e kontrollit konstatohet se kontrolluesi nuk përpunon të dhëna në rrjet përmes sistemit informatikë të instaluar në server. Sistemi Informatikë i DPM-së është realizuar sipas specifikimeve teknike të dokumentit “*Ndërtimi i sistemit të rrjetit IT, të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë*” i cili na u vu në dispozicion dhe për të cilin është marrë dhe opinion nga specialistë të AKSHI-it. Në këtë dokument është parashikuar siguria e sistemit, kufizimi i aksesit, ruajtja e gjurmëve përmes log-eve dhe të tjera masa në përputhje me legjislativonin në fuqi për sigurinë e të dhënave.

Logimi në sisteme realizohet me emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin fillestar të krijuar nga administratori i sistemit, i cili në momentin e regjistrimit ka përcaktuar edhe postin e punës në hierarkinë e institucionit. Për shkak se nuk është realizuar trajnimi i përdoruesve (punonjësve) nuk ka filluar puna me këtë sisteme. Kjo provohet dhe nga pamjet e printuara të realizuara në ndërfaqen e sistemit në server.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi pretendimet e kontrolluesit si dhe provat e administruara vëren se:

- Kontrolluesi “Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë” nuk ka një rregullore të shkruar për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen e të dhënave personale të klientëve, në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- Subjekti kontrollues e ka kryer detyrimin për njoftim ndaj Komisionerit por duhet të përditësojë adresën e Institucionit tek Formulari i Njoftimit pasi ka ndërruar godinë, si dhe zëvendësimin e personit të kontaktit me një person tjetër.
- Kompjuterët e nëpunësve nuk ishin të pajisur me fjalëkalim hyrës.
- Praktikat e përfunduara nga Sektori Juridik, Integritetit dhe Komunikimit nuk arkivoleshin në zyrën e arkiv-protokollit por mbaheshin për një afat të pacaktuar në dollapët e zyrës.

Konstatimet e sipërme përbëjnë shkelje administrative të:

- **Neni 27 pika 2/1 i Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

“Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat teknik-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale , në përpuhje me ligjin dhe rregullore të tjera”

Për sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

REKOMANDOJ

- 1- Në zbatim të neneve 27 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të merren masa për hartimin e një rregullore të shkruar për mbledhjet, mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen e të dhënave personale. (Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare www.kmdp.al, si dhe ofrojnë asistencën tonë).
- 2- Kryerja e këtyre detyrimeve të rëndësishme të kryhet brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dijani të këtij rekomandimi.
- 3- Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me sakrim pranë Komisionierit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- 4- Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas neni 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit *“Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas neni 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”*.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

Flora ÇABEJ (POGAÇE)

Me Urdhër e Porosi

KËSHILLTARI

Besnik PETRELA

